



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Ministria e Shëndetësisë dhe  
Mbrojtjes Sociale

Nr. 1073, datë 20.02.2022

Ministria e Financave dhe  
Ekonomisë

Nr. 3970, datë 13.2022

URDHËR I PËRRASHKËT

Nr. 148, datë 28.02.2022

“PËR

**NGRITJEN E GRUPEVE RAJONALE TË PUNËS PËR VLERËSIMIN, REFERIMIN  
PËR PUNËSIM DHE INTEGRIMIN SOCIAL TË ANËTARËVE NË MOSHË AKTIVE  
PUNË TË SKEMËS SË NDËHMËS EKONOMIKE”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit nr.882, datë 24.12.2019 “Për mekanizmin e bashkërendimit ndër-institucional të punës për referimin për punësim të individëve dhe anëtarëve në moshë aktive pune të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike” dhe Udhërit të Përbashkët nr.52, datë 26.01.2022 “Për miratimin e mekanizmit të referimit për punësimin dhe integrimin social të individëve në moshë aktive pune”

**URDHËROJMË:**

1. Në çdo qarq të vendit ngrihen grupet rajonale të punës (komisionet rajonale) të cilat kanë këtë përbërje:

- a) Përfaqësues nga Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror
- b) Përfaqësues nga Drejtoritë Rajonale të Punësimit dhe Aftësimin
- c) Përfaqësues nga Drejtoritë e Shërbimeve Sociale në Bashki

2. Përbërja e komisioneve rajonale është sipas listave bashkëlidhur këtij udhëri për 12 qarqe të vendit.

3. Komisioni Rajonal është përgjegjës për:

- a) identifikimin dhe referimin e anëtarëve në moshë aktive pune për tu trajtuar me programe të aftësimin dhe punësimin;
- b) identifikimin e individëve që nuk janë regjistruar si punëkërkuës të papunë, informimin e tyre mbi procedurën që duhet të ndjekin dhe orientimin e referimin e tyre;
- c) përcaktimin e profilit social ekonomik për çdo anëtar në moshë aktive pune;
- ç) plotësimin e Planeve Individuale të Mbështetjes për riintegrimin social të anëtarëve në moshë aktive pune;

c) asistimin dhe ndjekjen e raseve, duke siguruar edhe lidhjen e tyre me shërbimin të tjera, sipas nevojave të vlerësuara;

dh) ndjekjen e protokolleve të trajtimit me programe të këshillimit, aftësimi, ndërrnjohësimit dhe punësimit;

e) reformimin dhe trajtimin me programe sociale, përfshirë ato të strehimit, social-shërbimeve, si edhe programe të tjera që kanë në fokus fuqizimin e individit dhe të familjeve;

f) shkëmbimin e të dhënave në kohë reale nëpërmjet përdorimit të sistemeve të informacionit;

g) raportimin mbi fillimin e zbatimit të Planit Individual të Mbështetjes si edhe ndjekjen e ecursë së zbatimit të tij, për personat në moshë aktive pune, përfitues të ndihmës ekonomike;

4. Komisionet Rajonale raportojnë çdo muaj pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror dhe Agjencisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësim për veprimtarinë e kryer mbi referimin dhe trajtimin me shërbime sociale, të aftësimit dhe punësimit të anëtarëve në moshë aktive pune.

5. Shërbimi Social Shtetëror dhe Agjencia Kombëtare për Punësim dhe Aftësim raportojnë periodikisht pranë zëvendësministrave për çështjet sociale dhe të punësimit.

6. Në raportimet periodike, komisionet rajonale kujdesen që të ruhen të dhënat personale të individëve, sipas përcaktimeve të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.

7. Komisionet rajonale kanë të drejtë të thërrasin rast pas rasti, administratorët shoqërorë që kanë nën juridiksion e tyre familjet në nevojë, që janë në proces përfshirje në programin e reintegrimit social.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSMINISTËR

  
Daniela Sejferi  


ZËVENDËSMINISTËR

Olta Manjani

  
